

Ami Çarçani, mban pozicionin e Drejtoreshës së Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve për Çështjet e Zhvillimit Ekonomik, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ku udhëheq procesin e identifikimit të projekteve prioritare për financim nga fondet IPA dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë, duke koordinuar dhe monitoruar zbatimin e këtyre projekteve.

Më herët, ka mbajtur rolin si Drejtoreshë e Drejtorisë së Partneriteteve Strategjike, Diasporës dhe Migracionit, gjithashtu ka drejtuar Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, ku ka koordinuar projekte të financuara nga fondet IPA dhe donatorë të tjerë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjatë karrierës së saj, ajo ka pasur disa pozicione udhëheqëse, duke përfshirë edhe drejtimin e Drejtorisë për Përgatitjen dhe Fizibilitetin e Projekteve, Drejtorinë për Sigurimin e Cilësisë dhe Drejtorinë për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, duke treguar aftësi të forta menaxheriale dhe një angazhim të vazhdueshëm për përmirësimin e standardeve dhe zbatimin efektiv të projekteve të mëdha në sektorë kyç të zhvillimit.

Ami Çarçani përfunduar studimet e saj në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në Financë në vitin 2014. Përtej edukimit formal, ajo ka ndjekur një sërë trajnimesh profesionale, të fokusuara në tema si prokurimi publik, menaxhimi financiar i projekteve, kontabiliteti i sektorit publik, analizat kosto-përfitim për projektet e BE-së, dhe aftësi të ndryshme të nevojshme për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare dhe publike. Ka marrë pjesë në trajnime të organizuara nga institucione të njohura si Akademia Evropiane për Tatimet, Ekonominë dhe Ligjin në Berlin, Qendra e Ekselencës në Financë në Ljubljana, dhe Instituti European i Administratës Publike.

Trajnimet kanë përfshirë menaxhimin e ciklit të projekteve, analizën financiare, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve, si dhe përmirësimin e aftësive të buta, si aftësitë e komunikimit dhe negociatave.

Aftësitë e saj të gjera në menaxhimin financiar dhe prokurimin e projekteve të financuara nga BE, si dhe përvoja në auditime dhe kontroll të brendshëm, i kanë mundësuar asaj të kontribuojë në mënyrë efektive në projektet e mëdha zhvillimore në Shqipëri dhe rajon.